REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Nr. 2016 Prot Vlorë, më 30.12.2024

**VENDIM**

**Nr. 21, datë 24.12.2024**

**PËR MBARIMIN E MANDATIT TË KËSHILLTARIT TË KËSHILLIT TË QARKUT VLORË Z. SOKOL HODAJ**

Këshilli i Qarkut Vlorë në mbështetje të Nenit 75, pika 3 dhe 4 të Ligjit Nr. 139, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, për shkak të dorëheqjes së Këshilltarit të Këshillit të Qarkut Vlorë Z.Sokol Hodaj,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë mbarimin përpara afatit të mandatit të këshilltarit të Këshillit të Qarkut Vlorë Z.Sokol Hodaj.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sekretari i Këshillit të Qarkut Vlorë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Sekretar i Këshillit të Qarkut**

Vilasi Nasaj

**Specialist/Jurist**

Alma Myrtaj

**KRYETARI**

**Ervis Moçka**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË KËSHILLI I QARKUT VLORË

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës "Labëria" - Vlorë
Vlorë (AL)

Web site: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 690

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KËSHILLI I QARKUT VLORË**

# R E L A C I O N

**Të Nderuar Këshilltarë!**

Pranë institucionit të Këshillit të Qarkut Vlorë është protokolluar me Nr. 1911 Prot. datë 06.12.2024, shkresa e Këshillit të Bashkisë Selenicë Nr. 2487 Prot, datë 04.12.2024, me lëndë "Përcjellje e Vendimit të Këshillit të Bashkisë Selenicë", bashkëlidhur së cilës gjendet dokumentacioni i Këshillit të Bashkisë Selenice i cili me date 27.11.2024 ka marrë në shqyrtim zgjedhjen e anëtarit të Këshillit të Bashkisë Selenicë si përfaqësues në Këshillin e Qarkut Vlorë pas dorëheqjes së Z. Sokol Hodaj si anëtar i Këshillit Bashkiak Selenicë.

Në dokumentacionin e dërguar ndodhen:

1. Kërkesa e Këshillit të Bashkisë Selenicë Nr. 2487 Prot, datë 04.12.2024, me lëndë "Përcjellje e Vendimit të Këshillit të Bashkisë Selenicë".

2. Vendimi i Këshillit të Bashkisë Selenicë Nr.42, datë 27.11.2024 "Për zgjedhjen e anëtarit që do të përfaqësojë Këshillin e Bashkisë Selenicë në Këshillin e Qarkut Vlorë Znj.Nervida Lazaj".

Duke parë se dokumentacioni i dorëzuar nga ana e Këshillit të Bashkisë Selenicë është i plotë, bazuar në Nenin 75, pika 3 dhe 4 të Ligjit Nr. 139, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, Ju ftojmë që të procedojmë me miratimin e këtij vendimi.

Ju faleminderit!

**Sekretar i Këshillit të Qarkut**

Vllasi Nasaj

**Specialist/Jurist**

Alma Myrtaj

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës "Labëria" - Vlorë
Vlorë (AL)

Web site: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 600